



REPUBLICA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
DREJTORIA ASETIVE PRONAVE DHE STREHIMIT

Nr. 2132 / Prot.

Elbasan, më 23 .03.2019.

Lënda: Kthim përgjigje.

Qendra "Res Republica"  
Blv. "Gjergj Fishta", Nd.24, H.3, Ap.44

TIRANË


Në përgjigje të shkresës me Nr. 2132 Prot., datë 11.03.2019, "Kërkesë", bashkëlidhur ju dërgojmë Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 97 datë 19.07.2018 "Mbi miratimin në parim për dhënien me qira të objektit "Shkolla e Fshatit Katund i Ri" ndodhur në Nj.A.Bradashesh."

Përsa i përket informacionit/dokumentacionit në lidhje me procedurën e ndjekur apo subjektin fitues është e publikuar në Agjencinë e Prokurimit Publik .

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM  
Aulona Bylykbashi





REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1831 / Prot.

Elbasan, më / P. 07.2018

V E N D I M

Nr. 97 Datë: 19 .07.2018

"Mbi miratimin në parim për dhënie me qira të objektit "Shkolla e Fshatit Katund i Ri"  
ndodhur në Nj.A.Bradashesh"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës \_\_\_07.2018 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës, (sektori i pronave) bazuar në ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjin Nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; V.K.M Nr. 510 datë 10.6.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial"; V.K.M Nr. 54 datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore", i ndryshuar,

V E N D O S I :

1. Miraton në parim dhënien me qira të objektit "Shkolla e Fshatit Katund i Ri" ndodhur në Nj.Administrative Bradashesh, Elbasan sipas procedurave të konkurimit përcaktuar në V.K.M Nr 54, datë 05.02.2014.
2. Miraton kriteret e konkurimit si më poshtë vijon:

**A - Niveli i investimit:**

|                                      |              |
|--------------------------------------|--------------|
| Për investim nga 1-3 milion lekë     | 1 - 5 pikë   |
| Për investim nga 3.1- 6 milion lekë  | 6 - 10 pikë  |
| Për investim nga 6.1- 10 milion lekë | 11 -15 pikë  |
| Për investim mbi 10 milion lekë      | 16 - 25 pikë |

**B -- Kriteri i punësimit:**

|                     |              |
|---------------------|--------------|
| Deri në 10 punonjës | 1 - 5 pikë   |
| Nga 11-20 punonjës  | 6 - 10 pikë  |
| Nga 21-30 punonjës  | 11 - 15 pikë |
| Mbi 30 punonjës     | 16 - 25 pikë |

**C - Oferta e qirasë mujore:**

Oferta minimale është 75 lekë/m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimin 5 pikë  
Oferta minimale e truallit të lirë funksional të objekti është 20% (njëzet për qind) e tarifës  
dyshe me të detyrimit mujor të përcaktuar për sipërfaqen e ndërtimit.  
Për vlera mbi ofertën minimale 10 pikë

**D – Afati i dhënies me qira:**

20 vjet.

3. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi i Punës i ngritur me *Urdhër të Brendshëm* Nr. 634 datë 18.07.2018.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**

**Klajd Gripshi**



Spektori Pronave : R. Hida

Drejtorja A.P.S.:

Drejtorja Buxhetit:

Drejtorja Financës:

Drejtorja e P.P.A.A.B.F.:

Drejtorja e P.S.H.O.:

Drejtorja Juridike:

Zv. Kryetari:



R. Thanasi

A. Suli

M. Behtuli

A. Merkja

Q. Tusha

E. Këntuli

O. Delialli

K. Xhaxhi



**KRYETARI**

**Altin Idrizi**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**  
**SEKTORI JURIDIK**

Nr. 1382/prot.

Elbasan, më 01.08.2018

Lënda: Konfirmim akti


**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.97 datë 19.07.2018 "Mbi miratimin në parim për dhënie me qira të objektit "Shkolla e fshatit Katund i Ri" ndodhur në Njësinë Administrative Bradashesh", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Maksim Malaj**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
DREJTORIA ASETIVE PRONAVE DHE STREHIMIT

Nr. 3107/ Prot.

Elbasan, më 19.04.2019

Lënda: Kthim përgjigje.

Drejtuar: KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Rruga: "Abdi Toptani", Nd. 5.

**TIRANË**

Në lidhje me Tuajën Nr. 577/1 Prot., datë 12.04.2019 "Mbi ankimin...", Ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

Përsa i përket pikave 1, 2 dhe 3 në shkresën Tuaj, për informacionin e kërkuar duhet t'i drejtoheni Drejtorisë Rajonale Arsimore, Elbasan.

Në lidhje me informacionin e kërkuar në pikat 4, 5 dhe 6 sqarojmë se qiramarrës është subjekti "Fondacioni Turk Maarif" me Nipt L72202454L, administrator Z. Fatih Cankurt, dhe adresë: Rruga "Sulejman Delvina", P. Sigma/Aulona, K. 4, Ap. 5, Tiranë, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 97 datë 19.07.2018 "Mbi miratimin në parim për dhënien me qira të objektit "Shkolla e Fshatit Katund i Ri" ndodhur në Nj.A.Bradashesh."

Bashkëlidhur:

- F/Kopje V.K.B Nr. 97 datë 19.07.2018.
- F/Kopje "Njoftimi Fituesi" publikuar në Agjencinë e Prokurimit Publik.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin!

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Aulona Bylyk bashi





**BASHKIA KRUIJË**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TE ANULLIMIT**

**1. Emri dhe adresa e autoritetit**

Emri Bashkia Krujë  
Adresa Qendër, Krujë Sheshi "Mustafa Merlika (Kruja)"  
Tel/Fax 051122170  
E-mail [info@kruja.gov.al](mailto:info@kruja.gov.al)  
Faqja e Internetit [www.kruja.gov.al](http://www.kruja.gov.al)

1. Lloji i procedurës: Procedure e Hapur

2. Numri i buletinit te publikimit: Nr. 41 Date 15.10.2018

3. Objekti i kontratës : Për dhënien me qira të ekonomisë pyjore Kraste-Kruje në ngastrat pyjore me nr. 44a,45a,50a,57a,59a,64a,65a,68b,50a,52a per vjeljen e 56.27 ton degëza (gjethe ) të mersinës,ne sipërfaqen prej 68 ha, pronë e bashkisë Krujë me afat perdorimi 1 vjeçar

**4. Arsyet e Anullimit :**

Per shkak te nje lapsusi te bere nga ana e komisionit të përgatitjes së dokumenteve të konkurrimit, persa i perket shpalljes së njoftimit për konkurrim publik për dhënien me qira të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor te publikuar në Buletinin e Prokurimit Publik me Nr. 41 date 15.10.2018, i cili përmban të dhënat për sipërfaqen, aktivitetin, vendin dhe adresën ku mund të tërhiqet dokumentacioni i nevojshëm, si dhe datën e orën e paraqitjes së dokumentacionit, gabim qe ka te beje me sipërfaqen dhe ngastrat qe jane objekt i konkurimit public. Siperfaqja dhe ngastrat e publikuara ne Buletinin e Prokurimit Publik me Nr. 41 date 15.10.2018, nuk jane te njejta me sipërfaqen dhe ngastrat e percaktuara ne projektin e mersines te miratuar nga Ministria e Mjedisit dhe e Turizmit.

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi 22.10.2018

**BASHKIA ELBASAN**  
**NJOFTIM FITUESI**

Bashkia Elbasan në konkurrimin e zhvilluar më datë 06.09.2018 për dhënien me qira të objektit "Shkolla e Fshatit Katund i Ri" me numër pasurie 551/3, Z.K. 2124, me sipërfaqe të përgjithshme 1078 m<sup>2</sup>, nga kjo sip. ndërtimi 882 m<sup>2</sup> dhe sip. funksionale 196 m<sup>2</sup>, pronë e Bashkisë Elbasan për një afat 20-vjet, pas shqyrtimit të dokumentacionit tekniko- ligjor/ekonomik, rezultoi se në këtë konkurrim mori pjesë vetëm një subjekt dhe konkretisht:

Subjekti "Fondacioni Turk Maarif" me administrator Z.Fatih Cankurt.

Referuar procedurës së konkurrimit publik, informojmë e subjekti "Fondacioni Turk Maarif" me administrator **Z.Fatih Cankurt, me NIPT L72202454L** me adresë Rr. "Sulejman Delvina", P.

SIGMA/AULONA, K.4, Ap. 5, Tiranë, për marrjen me qira të të objektit “Shkolla e Fshatit Katund i Ri”, numër pasurie 551/3, Z.K. 2124, me sip. të përgjithshme 6666.27 m<sup>2</sup>, nga kjo sip. ndërtimi 4022.44 m<sup>2</sup> dhe sip. funksionale 2643.83 m<sup>2</sup>, pronë e Bashkisë Elbasan, me çmimin 75 lekë/m<sup>2</sup> për sipërfaqen ndërtimore dhe për sipërfaqen e truallit funksional 20% e tarifës dysheme të detyrimit mujor të përcaktuar për sipërfaqen e ndërtimit. Ky çmim përkon me atë të vendosur nga ana jonë në njoftimin për botim. Në këto kushte subjekti “Fondacioni Turk Maarif ” me administrator Z.Fatih Cankurt shpallet fitues me 55 pikë.

Jeni të lutur të paraqiteni pranë Bashkisë Elbasan në Drejtorinë e Aseteve Pronave dhe Strehimit brenda 10 ditëve nga data e publikimit të këtij njoftimi për të lidhur kontratën e qirasë.

Njoftimi i klasifikimit është bërë më datë 21.09.2018.  
Ankesa nuk ka.

1382  
25.7.2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4831/ Prot.

Elbasan, më 19.07.2018

V E N D I M

Nr. 97 Datë: 19.07.2018

"Mbi miratimin në parim për dhënie me qira të objektit "Shkolla e Fshatit Katund i Ri" ndodhur në Nj.A.Bradashesh"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës \_\_.07.2018 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës, (sektori i pronave) bazuar në ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjin Nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; V.K.M Nr. 510 datë 10.6.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial"; V.K.M Nr. 54 datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore", i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Miraton në parim dhënien me qira të objektit "Shkolla e Fshatit Katund i Ri" ndodhur në Nj.Administrative Bradashesh, Elbasan sipas procedurave të konkurimit përcaktuar në V.K.M Nr 54, datë 05.02.2014.
2. Miraton kriteret e konkurimit si më poshtë vijon:

**A - Niveli i investimit:**

|                                      |              |
|--------------------------------------|--------------|
| Për investim nga 1-3 milion lekë     | 1 - 5 pikë   |
| Për investim nga 3.1- 6 milion lekë  | 6 - 10 pikë  |
| Për investim nga 6.1- 10 milion lekë | 11 -15 pikë  |
| Për investim mbi 10 milion lekë      | 16 - 25 pikë |

**B – Kriteri i punësimit:**

|                     |              |
|---------------------|--------------|
| Deri në 10 punonjës | 1 - 5 pikë   |
| Nga 11-20 punonjës  | 6 - 10 pikë  |
| Nga 21-30 punonjës  | 11 - 15 pikë |
| Mbi 30 punonjës     | 16 - 25 pikë |



**C - Oferta e qirasë mujore:**

Oferta minimale është 75 lekë/m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimin 5 pikë  
Oferta minimale e truallit të lirë funksional të objekti është 20% (njëzet për qind) e tarifës  
dyshe me të detyrimit mujor të përcaktuar për sipërfaqen e ndërtimit.  
Për vlera mbi ofertën minimale 10 pikë

**D – Afati i dhënies me qira:**

20 vjet.

3. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi i Punës i ngritur me *Urdhër të Brendshëm* Nr. 634 datë 18.07.2018.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**

**Klajd Gripshi**



**KRYETARI**

**Altin Idrizi**



14/4

42/4

Pershendetje!

Ne pergjigje te shkreses nr 577/1 date 12.04.2019 te "Komisionerit per Informimin dhe Mbrojtjen e te Dhenave Personale " pika 1,2,3 ju informojme si me poshte:

1. Drejtoria Arsimore Rajonale Elbasan nuk ka pasur nje studim te hartuar mbi numrin e nxenesve per nevojat e ndertimit te kesaj shkolle ne fshatin "Katund i Ri"
2. DAR Elbasan nuk posedon kopje te ketij studimi.
3. Aresyeja e mos hapjes se kesaj shkolle per nxenesit eshte mos pasja e nje studimi te plote per numurin e nxenesve ne kete njesi administrative

Ju bejme me dije se e gjithë nisma per ndertimin e kesaj shkolle ka qene e ish Komunes Bradashesh e cila e ka ndertuar pa marre parasysht mendimin e DAR Elbasan .

Me respekt

Ali Kardhashi  
Pergjegjes i SPZH  
DAR Elbasan  
Lagja Partizani, Rrugag janaq Kilica  
3001, Elbasan, Albania

Pershendetje ! Keshilli bashkiak ka marre vetem nje vendim me nr  
97.date 19.07.2018 Mbi miratimin ne parim dhe per dhenien e objektit

Shkolla e fshatit Katund i Ri

Duke ju falenderuar per mirekuptimin



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN

Nr. 433 Prot.

Elbasan, më 11.11.2018

ZYRA E NOTERISË TIRANË

Nr. 2224 Rep.

Nr. 303 Kol.



**KONTRATË QIRAJE**

Për dhënie me qira të objektit "Shkolla e Fshatit Katund i Ri" me numër pasurie 551/3, Z.K.2124, me sip.të përgjithshme 6666.27 m<sup>2</sup>, nga kjo sip.ndërtimi 4022.44 m<sup>2</sup> dhe sip. funksionale 2643.83 m<sup>2</sup>, pronë e Nj. Administrative Bradashesh, Bashkia Elbasan, me afat 20-vjet.

Në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Vendimit nr. 54, datë 05.02.2014, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitcozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar, Udhëzimit Nr. 13, datë 26.04.2018, "Për zbatimin e VKM-së Nr. 54, datë 05.02.2014...". Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 97, datë 19.07.2018, "Mbi miratimin në parim për dhënie me qira të objektit "Shkolla e Fshatit Katund i Ri" ndodhur në Nj.A Bradashesh", me numër pasurie 551/3, Z.K.2124, me sip.të përgjithshme 6666.27 m<sup>2</sup>, nga kjo sip.ndërtimi 4022.44 m<sup>2</sup> dhe sip. funksionale 2643.83 m<sup>2</sup>, me afat 20-vjet, nëpërmjet procedurës së konkurrimit".


Bashkia Elbasan, në përfundim të konkurrimit, të zhvilluar me datë 06.09.2018, organizuar me Urdhër të titullarit me Nr. 634 datë 18.07.2018, shpalli fitues Fondacionin "Turk Maarif" me administrator Z. Fatih Cankurt si dhe bazuar në nenet 801- 825 të Kodit Civil, palët bien dakord të hartojnë këtë kontratë, me kushtet si më poshtë:

1- Bashkia Elbasan, përfaqësuar nga Kryetari, Z.Qazim Sejdimi, që më poshtë do të quhet "Qiradhënës"

2- Fondacioni "Turk Maarif", përfaqësuar nga Administratori Z. Fatih Cankurt, me seli në Rrugën "Sulejman Delvina", Pallati Sigma/Aulona, Kati 4, Ap.5, Tiranë, i identifikuar si Shoqatë Jo-Fitimprurëse me NIPT L72202454L, i identifikuar me Pasaportë nr. ~~XXXXXXXXXX~~ datë lëshimi 13.04.2017, që më poshtë do të quhet "Qiramarrës".

## NENI 1 OBJEKTI I KONTRATËS

1.1 Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira të objektit "Shkolla e Fshatit Katund i Ri" me numër pasurie 551/3, Z.K.2124, me sip.të përgjithshme 6666.27 m<sup>2</sup>, nga kjo sip.ndërtimi 4022.44 m<sup>2</sup> dhe sip. funksionale 2643.83 m<sup>2</sup>, sipas planvendosjes bashkëlidhur.



## NENI 2 QËLLIMI I PËRDORIMIT

2.1 Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në gëzim të përkohshëm i objektit të përcaktuar në NENIN 1, për ushtrimin e aktivitetit me qëllim realizimin e programeve mësimore.

## NENI 3 KOHËZGJATJA

3.1 Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë 20 (njëzet) vjeçare.

3.2 Kontrata hyr në fuqi në datën e nënshkrimit.

3.3 Kontrata është e vlefshme me depozitimin e garancisë së kontratës që është në vlerën 1.024.021,35 (Njëmilion e njëzet e katër mijë e njëzet e një presje tridhjetë e pesë lekë) të ngurtësuar për Bashkinë Elbasan në një nga bankat e nivelit të dytë si dhe dorëzimin me procesverbal të objektit të qirasë.

## NENI 4 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRADHËNËSIT

4.1 "Qiradhënësi" dorëzon pronën e përcaktuar në pikën 1.1 të kësaj kontrate, të lirë për t'u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet procesverbali i dorëzimit të ambientit që jepet me qira, i cili është pjesë përbërëse e kontratës.

4.2 "Qiradhënësi" ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e "Qiramarrësit".

4.3 "Qiradhënësi" është i detyruar t'i garantojë "Qiramarrësit" gëzimin e qetë të pronës, objekt i kësaj kontrate ndaj të tretëve, të cilët mund të ngrejnjë pretendime për të drejtën e tyre mbi pronën.

4.4 "Qiradhënësi" ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës, kur "Qiramarrësi" shkel detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit 30 ditë përpara me shkrim.



NENI 5  
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRAMARRRËSIT

5.1 "Qiramarrësi" ka të drejtë që sipas legjislacionit në fuqi të përdorë e të gëzojë pronën e marrë me qira dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.

5.2 "Qiramarrësi" ka për detyrë që të përdorë pronën objekt të kësaj kontrate për qëllimin e destinacionin e parashikuar në NENIN 2.

5.3 "Qiramarrësi" detyrohet të paguajë detyrimin mujor të qirasë brenda afatit të përcaktuar në këtë kontratë. **Për çdo ditë vonesë do të paguajë një kamatë ditore prej 0,1% të vlerës së qirasë mujore.**

5.4 "Qiramarrësi" detyrohet të kryejë investime në vlerën 28.750.000 lekë në objektin e marrë me qira sipas fazave kohore të përcaktuara në plan-biznesin e paraqitur në konkurrim.

5.5 "Qiramarrësi" sipas parashikimit për punësimin të shprehur në plan-biznesin e paraqitur në konkurrim detyrohet që në objektin e marrë me qira të punësojë 25 punonjës për vitin e parë dhe 32 punonjës brenda vitit të pestë e deri në përfundim të kësaj kontrate. "Qiramarrësi" detyrohet të zbatojë legjislacionin në fuqi "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi".

5.6 "Qiramarrësi" detyrohet të paraqesë tek "Qiradhënësi" informacion për nivelin e punësimit mesatar vjetor të realizuar në objekt në vitin paraardhës, shoqëruar me vërtetim nga institucionet shtetërore, si dhe për investimet e kryera në objekt të shoqëruara me dokumentacionin përkatës.

5.7 "Qiramarrësi" në rast të mosrealizimit të treguesve për investimin dhe punësimin sipas pikave 5.4 dhe 5.5 të këtij neni detyrohet t'i paguajë "Qiradhënësit" penaltitet në masën 10% të vlerës së investimit të pakryer për çdo vit, deri në realizimin e plotë të tij dhe 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë në vit, për çdo punonjës të papunësuar.

5.8 "Qiramarrësi" detyrohet që në momentin e përfundimit të kësaj kontrate të dorëzojë pronën të padëmtuar.

5.9 "Qiramarrësi" në përfundim të kësaj kontrate ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga prona, pa dëmtuar atë. "Qiradhënësi" nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga "Qiradhënësi".

5.10 "Qiramarrësit" nuk i lejohet që pronën e dhënë me qira t'a japë me nënqira ose t'ia kalojë kontratën një tjetri.

5.11 Çdo njoftim apo shkresë dërguar "Qiramarrësit" në adresën e mësipërme do të konsiderohet e marrë nga "Qiramarrësi", me kushtin që dërguesi të disponojë mandatin postar të postës.

5.12 Në rast të ndryshimit të adresës nga njëra palë, kjo e fundit detyrohet t'i komunikojë palës tjetër adresën e re. Në rast të kundërt, komunikimet e dërguara në adresën e mëparshme konsiderohen të vlefshme.

5.13 Në çdo rast, "Qiradhënësi" ka të drejtë që të bëjë njoftime me shpallje publike në stendën e bashkisë, në ambjentet e Administratës së Njësisë Bashkiake Nr.5 (Tiranë), ku ndodhet selia, si dhe në ambjentin objekt qiraje. Shpallja qëndron 5 ditë e afishuar dhe pas plotësimit të afatit 5 ditor, njoftimi konsiderohet i marrë rregullisht dhe i njohur për palën tjetër.



**NENI 6**  
**PAGESA E QIRASË**


- 6.1 "Qiramarrësi" detyrohet të paguajë "Qiradhënësit" detyrimin mujor në vlerën 341340,45 (treqind e dyzet e një mijë e treqind e dyzet pikë dyzet e pesë) lekë.
- 6.2 Pagesa e qirasë do të jetë mujore dhe do të bëhet brënda datës 10 të fillimit të muajit.
- 6.3 Pagesa e qirasë fillon me marrjen në dorëzim të objektit të kontratës por jo me vone se një muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.
- 6.4 Para nënshkrimit të kontratës "Qiramarrësi" ka paguar garancinë e kontratës, e cila është e barabartë me vlerën e tre muajve të qirasë dhe qëndron e ngurtësuar deri në përfundim të kësaj kontrate. Nëse qiramarrësi për 3 (tre) muaj rresht nuk kryen pagesën e qirasë, pas rakordimit të kryer, shlyerjes së detyrimeve dhe nxjerrjen e diferencave, garancia e kontratës automatikisht kalon në favor të "Qiradhënësit".

**NENI 7**  
**ZGJIDHJA E KONTRATËS**


- 7.1 Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në NENIN 3 të kësaj kontrate.
- 7.2 Kontrata mund të zgjidhet para afatit:
- a. në marrëveshje midis palëve.
  - b. kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet për shkak të një force madhore, aq sa nuk mund të sigurohen të ardhura sa të shlyhet shpërblimi i përcaktuar në kontratë.
  - c. kur "Qiramarrësi" shkel detyrimet e marra përsipër në NENET 5 dhe 6 të kësaj kontrate.
- 7.3 Kontrata pushon automatikisht së vepruari kur "Qiramarrësi" për 3 (tre) muaj rresht nuk kryen pagesën e qirasë. "Qiramarrësi" detyrohet të dorëzojë ambjentin objekt qiraje 15 ditë pas marrjes së njohimit për zgjidhjen e kontratës nga "Qiradhënësi".
- 7.4 Kontrata pushon automatikisht së vepruari 30 ditë pas njohimit me shkrim të "Qiradhënësit", për zgjidhjen e kontratës para afatit, sipas pikës 7.2 të saj edhe nëse "Qiramarrësi" nuk ka reaguar me shkrim.

**NENI 8**  
**PËRGJEGJËSITË E PALËVE**

- 8.1 Palët përgjigjen për mosrespektimin e kushteve të kësaj kontrate.
- 8.2 Palët janë të detyruar që në fillim të çdo viti të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta për realizimin e detyrimeve në derdhjet e pagesës, të nivelit të punësimit, të nivelit të investimit dhe kamatat ose gjokat (në rastet kur ka të tilla), të vendosura sipas neneve të kësaj kontrate. Këto akte rakordimi janë pjesë e dosjes së monitorimit të qiradhënies.
- 8.3 Për qëllimet e kësaj kontrate me "Forcë Madhore" do të kuptohet një ngjarje që është jashtë kontrollit të palëve, si termete, përmbytje, lufta etj. Në këto raste palët janë të detyruara të njoflojnë njëra-tjetrën me shkrim. Koha e parashikuar për plotësimin e detyrimeve do të zgjatet për aq kohë sa do të vazhdojnë këto rrethana.



8.4 "Qiramarrësi" përjashtohet nga detyrimet e pagesës për kohën e vazhdimit të "Forcës Madhore" dhe mos kryerjes së aktivitetit për këtë shkak. Kjo periudhë do të përcaktohet me marrëveshje midis palëve.



#### NENI 9

#### DISPOZITAT E FUNDIT

9.1 Për gjithëçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë, palët do t'u referohen dispozitave të Kodit Civil në fuqi.

9.2 Pjesë e kësaj kontrate janë Plan Biznesi i paraqitur para komisionit të konkurrimit dhe procesverbali i marrjes në dorëzim të objektit sipas kontratës së qirasë.

9.3 Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate do të zgjidhen me mirëkuptim dhe në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës kompetente.

#### NENI 10 TË TJERA

Brenda një muaji nga nënshkrimi i saj, kontrata duhet të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Shpenzimet noteriale të kësaj kontrate i ngarkohen "Qiramarrësit".

Kjo kontratë është hartuar në 9 (nëntë) kopje origjinale. Pasi i'u lexua palëve, u kuptua, u pranua prej tyre, si dhe u nënshkrua para meje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë, dhe unë noter Julian Zhelegu, Dhoma e Noterëve Tiranë, me seli në Rr. "Pjetër Bogdani", Nr. 13, Tiranë, me licensë profesionale Nr.2762/1, datë 10.04.2006, në bazë të nenit 801 e në vijim të Kodit Civil, e vërtetoj atë si të rregullt.

**QIRAMARRËSI**  
**"FONDACIONI TURK MAARIF"**  
**ADMINISTRATORI**



Sektori Peonave:  
Drejtoria T.P.S.  
Drejtoria Buxhet  
Drejtoria Financë  
Drejtoria P.P.A.B.F.  
Drejtoria Dreg. Juvenilë  
A. KRYETARI

R. Thana  
A. Suli  
M. B. Ibrahimi  
A. Merxha  
Q. Tusha  
Q. Dethallisi  
K. Nisxhi

Perktheu  
Enkelejda Koka



**NOTER**  
**Julian Zhelegu**

Banka Kombetare Tregtare Sh.a  
Dega Qendrore  
Adresa: Sheshi Italia, Hotel Mak Albania,  
Tirane, Shqiperi  
Nr. Prot 1672



Datë: 05 Nentor 2018

Tipi i Garancisë: Garanci Bankare

Referenca: ~~XXXXXXXXXX~~

Garantuesi: **Banka Kombetare Tregtare Sh.a**  
**Dega Qendrore**  
Adresa: Sheshi Italia, Hotel Mak Albania, Tirane, Shqiperi

Aplikanti: **Dega Fond Maarif ne Republike e Shqiperise**  
Adresa: Rruga "Sulejman Delvina", Pallati Sigma/Aulona, Kati 4,  
Apartamenti Nr. 5, Tirane, Shqiperi

Përfituesi: **Bashkia Elbasan**  
Adresa: Rruga "Qemal Stafa", Elbasan, Shqiperi

Marrëveshja bazë: Detyrimi i Aplikantit ne lidhje me kontraten e qerese qe do te nenshkruhet per objektin "School of Village Katund i Ri" me Nr. 551/3, ZK2124.

Shuma & Valuta e Garancise: 1,023,996.15 Leke (Nje Milion e Njzetete e Tre Mije e Nenteqind e Netedhjete e Gjashte pike Pesembdhjete)

Cdo document shtese I kerkuar si mbeshtetes per kerkesen per pagese, pervec deklarates qe kerkohet ne tekstin e LG meposhte: Nuk ka

Gjuha e dokumenteve: Gjuha e dokumentave do te jete ne gjuhen shqipe.

Forma e prezantimit: Kerkese per Pagese me shkrim e nenshkruar dhe vulosur rregullisht nga firmat e autorizuara te Përfituesit.

Vendi i prezantimit: **Banka Kombetare Tregtare Sh.a**  
**Dega Qendrore**  
Adresa: Sheshi Italia, Hotel Mak Albania, Tirane Shqiperi

Skadencia: 08 Nentor 2038

Pala përgjegjëse për komisionet: Aplikanti

Si Garantues, ne marrim përsipër në mënyrë të parevokueshme t'i paguajmë Përfituesit çdo shumë deri në Shumën e Garancisë përkundrejt prezantimit nga Përfituesi të kërkesës për pagesë në përputhje me kushtet e Garancisë, në formën e prezantimit të treguar më lart, mbështetur nga dokumente të tilla si specifikuar më lart dhe në çdo rast nga Deklarata e




Përfutuesit, në kërkesë apo në një dokument të veçantë të nënshkruar që shoqëron ose identifikon kërkesën, ku tregohet në çfarë aspekti Aplikanti është në shkelje të detyrimeve të tij që rrjedhin nga Marrëveshja Bazë.


Çdo kërkesë nën këtë Garanci duhet të merret nga ne në ose përpara Skadencës në Vendin e prezantimit të specifikuar më lart.

Kjo Garanci është subjekt i Rregullave Uniforme për Garancitë me Kërkesë (URDG) 2010 Revision, Publikimi i ICC Nr. 758.

Nenshkrimet,

  
Drejtori Degtur  
Turan SAN

Ass. Manaxhere Operacioneve  
Aurela HOXHIA







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
DREJTORIA ASETIVE PRONAVE DHE STREHIMIT

Nr. 4827/Prot.  
14

Elbasan 06.11.2018

PROÇES - VERBAL

"Mbi dorëzimin e objektit "Shkolla e Fshatit Katund i Ri" dhënë me qira në Nj. Administrative Bradashesh, Bashkia Elbasan Z.K.2124"

I mbajtur sot më datë 06.11.2018 ndërmjet komisionit të Bashkisë Elbasan për dorëzimin e objektit të dhënë me qira në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 97, datë 19.07.2018 "Mbi dhënie me qira të objektit "Shkolla e Fshatit Katund i Ri" dhënë me qira në Nj. Administrative Bradashesh, Bashkia Elbasan" ndodhur në Z.K. 2124" dhe Fondacionit "Turk Maarif" me administrator Z. Fatih Cankurt që merr në dorëzim ambientin me të dhënat sipas tabelës së mëposhtme.

| Nr. | Lloji i Ambientit          | Sipërfaqja në m <sup>2</sup> | Lagja            | Z.K  | Shënime         |
|-----|----------------------------|------------------------------|------------------|------|-----------------|
| 1.  | Ndërtesë + Truall (Totale) | 6666.27                      | Nj.Ad.Bradashesh | 2124 | Gjendje të mirë |
| 1.1 | Sip.funksionale            | 2643.83                      | Nj.Ad.Bradashesh | 2124 | Gjendje të mirë |
| 1.2 | Kati përdhe                | 1356.17                      | Nj.Ad.Bradashesh | 2124 | Gjendje të mirë |
| 1.3 | Kati i parë                | 1232.48                      | Nj.Ad.Bradashesh | 2124 | Gjendje të mirë |
| 1.4 | Kati i dytë                | 718.41                       | Nj.Ad.Bradashesh | 2124 | Gjendje të mirë |
| 1.5 | Papafingo                  | 715.38                       | Nj.Ad.Bradashesh | 2124 | Gjendje të mirë |

Në rastin kur "Qiramarrësi" kërkon të bëjë investime që i shërbejnë aktivitetit dhe punës së tij si: restaurime, përmirësimin e pamjeve të brendshme dhe të jashtme pa ndërhyrje në konstrukcion të godinës, atëherë këto i lejohen të bëhen vetëm me lejen e miratimit e "Qiradhënësit". Këto investime nuk njihen nga ana e "Qiradhënësit" (Bashkia Elbasan). Ky Proçes -Verbal mbahet në 9 (nëntë) kopje të cilat i bashkëngjiten kontratave të qirasë.

**Dorëzuesit :**

1. Andi Liçi (Admin.Nj. Ad.Bradashesh)
2. Reshit Hida (Spec. Sek. Pronave)
3. Erion Zejnelhoxha (Spec. Drejtoria Financë)

Marrësi në Dorëzim

Fatih Cankurt

